



# Shteti neglizhon harmonizimin e pensioneve me koston e jetesës



Autorë: Naim Jakaj dhe Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Rockefeller Brothers Fund.

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Tetor, 2024  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# Përmbajtja

07

Përmbledhje ekzekutive

09

Histori e shkurtër e pensioneve në Kosovë para vitit 1999

10

Administrimi ndërkombëtar i pensioneve dhe periudha pas shpalljes së Pavarësisë

13

Mbrojtja sociale e pensionistëve sipas Kushtetutës së Kosovës

15

Jeta e dinjitetshme e pensionisteve - obligim shtetëror

16

Parimet dhe standardet ndërkombëtare mbi pensionet

18

Praktikat ndërkombëtare të rregullimit të pensioneve

21

Premtimet elektorale për reformë pensionale të Lëvizjes VETËVENDOSJE!

22

Mos harmonizimi i pensioneve me kushtet e jetesës në Kosovë

23

Pensionet aktuale mirëmbajnë varfërinë

25

Neglizhenca e Qeverisë i izolon të moshuarit

26

Ngritja e vonshme dhe e pamjaftueshme e shumës së pensioneve

28

Intervenimi në skemat pensionale nga Qeveria dhe Kuvendi pas detyrimit nga Gjykata Kushtetuese

## SHKURTESAT

<b>KRK</b>	Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
<b>PKP</b>	Platforma e Konsultimeve Publike
<b>PL 2024</b>	Programi Legjislativ për vitin 2024
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>GJK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>LSPFSh</b>	Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti
<b>RRPK</b>	Rregullorja e Punës së Kuvendit
<b>IKD</b>	Instituti i Kosovës për Drejtësi
<b>QRK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës

# 1. Përmbledhje ekzekutive

Sistemi i pensioneve në Kosovë ka një histori komplekse që fillon gjatë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, kur Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë. Në atë kohë, pensionet ishin të bazuara në kontributet e punëtorëve dhe garantoheshin për të gjithë ata që kishin një histori të rregullt punësimi. Shqiptarët e Kosovës përfitonin nga skemat e sigurimeve sociale që administroheshin nga institucionet jugosllave deri në vitin 1989, kur suprimimi i autonomisë së Kosovës solli ndryshime të thella politike dhe ekonomike. Gjatë viteve '90, shqiptarët u përjashtuan nga skemat e sigurimeve sociale dhe shumë prej tyre humbën vendet e punës, duke humbur edhe të drejtat e pensioneve. Diskriminimi i theksuar gjatë kësaj periudhe çoi në izolimin dhe varfërinë e një pjese të madhe të popullsisë që kishte kontribuar për vite me radhë në fondet e sigurimeve sociale.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Kosova u vendos nën administrimin e UNMIK-ut, i cili filloi procesin e reformimit të sistemit pensional. Në vitin 2002, u krijua një sistem i ri pensional që përfshinte tri shtylla kryesore: pensionet bazë të financuara nga shteti, pensionet e detyrueshme të bazuara në kontribute, dhe pensionet vullnetare. Sistemi u krijua për të ofruar një mbrojtje minimale për pensionistët, pavarësisht historisë së tyre të punësimit, me qëllim të zbutjes së varfërisë. Pensioni bazë u vendos në shuma fillestare shumë të ulëta, dhe pavarësisht disa rritjeve gjatë viteve, ky pension vazhdoi të jetë i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat bazike të jetesës. Rritjet e pensioneve kanë qenë të paqëndrueshme dhe nuk janë harmonizuar me inflacionin ose koston e jetesës. Pas vendosjes fillestare të pensionit bazë, shumat janë rritur gradualisht në vitet e para, por nga viti 2006 deri në vitin 2019 nuk ka pasur rritje të vazhdueshme. Rritja më e rëndësishme u bë në vitin 2019, kur pensionet bazike u rritën me vendim qeveritar, por sërish kjo u bë pa ndonjë analizë të thellë që të merrte parasysh kushtet ekonomike dhe varfërinë në rritje. Për më tepër, nga viti 2022, pensionet janë rritur në shumën prej 100 eurosh për shumicën e përfituesve, por kjo masë ka qenë e pamjaftueshme për të adresuar nevojat në rritje të pensionistëve.

Një nga problemet më të mëdha me sistemin e pensioneve në Kosovë ka qenë mungesa e harmonizimit me koston e jetesës dhe inflacionin. Pavarësisht rritjeve sporadike, pensionet nuk janë përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me shpenzimet bazike, dhe kjo ka bërë që shumë pensionistë të mbeten në varfëri. Inflacioni dhe rritja e koston e jetesës kanë prekur drejtpërdrejt jetën e pensionistëve, duke shkaktuar vështirësi në përbalimin e shpenzimeve për ushqim, energji, dhe shërbime shëndetësore. Kjo situatë ka përkeqësuar kushtet e jetesës për këtë kategori të ndjeshme dhe ka thelluar izolimin e tyre shoqëror.

Situatë e tillë e vendimeve ad-hoc dhe pa konsultime me përfaqësuesit e pensionistëve, për rritjen e pensioneve e patëm edhe më 7 tetor 2024 ku Kryeministri Albin Kurti dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati njoftuan rritjen prej 20% të disa kategorive të pensioneve në Kosovë. Kjo rritje përfshin pensionet bazike dhe kontributpaguese, pensionet e aftësisë së kufizuar dhe pensionet për disa kategori të luftës, duke përfshirë veteranët dhe viktimat e luftës. Kjo masë pritet të përmirësojë disi gjendjen financiare të pensionistëve, megjithëse vjen në një periudhë që ngjallë dyshime për motive elektorale.

Megjithëse rritja e pensioneve mirëpritet nga qytetarët dhe nga shoqëria civile, kritikën kryesore qëndrojnë në mungesën e një analize të thellë dhe harmonizimit me koston e jetesës, që është një obligim ligjor i Qeverisë. Ngritja erdhi pas një periudhe të gjatë ku pensionistët kanë përjetuar rënie të fuqisë blerëse, dhe shumë e shohin këtë veprim si një lëvizje politike, e cila nuk reflekton një politikë sociale të qëndrueshme dhe të drejtë për këtë kategori.

Pavarësisht rritjes së pensioneve, kjo lëvizje e qeverisë mund të konsiderohet edhe e pamjaftueshme për të përballuar kushtet e jetesës, veçanërisht në krahasim me rritjen e pagave për pozitat e larta publike. Rritjet e pagave të zyrtarëve qeveritarë janë ndjeshëm më të mëdha se ato të pensionistëve, duke theksuar se sistemi pensional në Kosovë ka nevojë për rregullim dhe reformim më të thellë, për të siguruar një standard dinjitoz për pensionistët.

Raporti i fundit i UNDP-së për varfërinë tregon se pensionistët në Kosovë janë ndër grupet më të rrezikuara nga varfëria. Shpenzimet për nevojat bazike janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, duke ndikuar më së shumti tek pensionistët që kanë të ardhura të kufizuara. Shumë prej tyre janë detyruar të kufizojnë konsumin ushqimor ose të heqin dorë nga shërbimet mjekësore për të përballuar rritjen e kostove. Sipas raportit, kjo gjendje ka kontribuar në një ngritje të izolimit, stresit dhe depresionit mes pensionistëve, të cilët po përballen me një situatë të rënduar ekonomike dhe sociale.

Mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm për indeksimin e pensioneve ka reflektuar në humbjen e fuqisë blerëse të tyre. Në shumë vende evropiane, përfshirë Gjermaninë dhe Francën, ekzistojnë mekanizma të qartë për të rritur pensionet në përputhje me inflacionin dhe rritjen e koston së jetesës. Në Kosovë, mungesa e një mekanizmi të tillë ka bërë që pensionistët të mbeten prapa në krahasim me rritjen e çmimeve. Kjo mospërputhje ka ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së tyre, duke i lënë ata në varësi të ndihmës shtetërore dhe të afërmeve për mbijetesë.

Pavarësisht premtimeve për reforma në sistemin pensional, qeveria aktuale ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e gjendjes. Lëvizja Vetëvendosje, që gjatë fushatës së vitit 2021 premtoi reforma të thella për përmirësimin e skemave pensionale, nuk ka arritur të realizojë këto premtime. Projektligjet e propozuara ende nuk janë miratuar dhe pensionistët vazhdojnë të përballen me një sistem të papërshtatshëm dhe të paqëndrueshëm.

Mungesa e zbatimit të ligjeve që përcaktojnë rishikimin vjetor të pensioneve përbën një shkelje të të drejtave të pensionistëve dhe një dështim të qeverisë për t'i mbrojtur ata. Ligjet ekzistuese parashikojnë që pensionet duhet të rriten çdo vit në përputhje me inflacionin, por ky detyrim nuk është zbatuar, duke lënë mijëra pensionistë në kushte të vështira ekonomike. Kjo mospërputhje me ligjet ekzistuese ka thelluar pabarazitë dhe ka përkeqësuar kushtet e jetesës për këtë kategori të ndjeshme. Kjo situatë përbën një shkelje ligjore sistematike nga qeveria, duke mos zbatuar detyrimet ligjore për rishikimin vjetor të pensioneve dhe duke cënuar të drejtat themelore ekonomike të pensionistëve.



## 2. Histori e shkurtër e pensioneve në Kosovë para vitit 1999

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhunshëm ishte pjesë e Jugosllavisë, dhe sistemi i pensioneve në Kosovë funksiononte në përputhje me politikat federative jugosllave. Pensionet administroheshin nga fondet shtetërore të Jugosllavisë dhe u përkisnin atyre që kishin një histori të punësimit të rregullt. Në këtë periudhë, sigurimet sociale, përfshirë pensionet, ishin të garantuara për të gjithë punëtorët që kontribuonin në fondet pensionale. Skema e pensioneve ishte kryesisht e bazuar në kontributet e punëtorëve. Kriteri kryesor për të përfituar pension ishte periudha e kontributit, dhe përfitimet e pensioneve përcaktoheshin në bazë të viteve të punës dhe të ardhurave të fituara.[1]

Në vitin 1989, me suprimimin e autonomisë së Kosovës, sistemi i sigurimeve sociale filloi të çrregullohej. Pensionet dhe përfitimet sociale për shqiptarët e Kosovës u bënë gjithnjë e më të paqasshme, ndërsa administrimi i tyre kaloi nën kontrollin e institucioneve serbe.

Gjatë viteve '90, shqiptarët e Kosovës u përjashtuan nga skemat e sigurimeve sociale të administruara nga Serbia. Shumë prej tyre u pushuan nga puna dhe u privuan nga pensionet e tyre, duke i lënë pa mbrojtje sociale të rregullt. Kjo periudhë karakterizohej nga diskriminimi masiv, dhe shumë kontribues nuk morën përfitimet e tyre, përfshirë pensionet e pleqërisë. Krejt kjo erdhi si pasojë e miratimit të dy ligjeve të veçanta nga Kuvendi Popullor i Serbisë, Ligjit mbi Veprimin e Organeve Republikane në Kushte të Posaçme dhe Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës në Kushte të Posaçme.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, sistemi i sigurimeve sociale dhe i pensioneve i trashëguar nga Jugosllavia u shpërbë plotësisht. Pensionistët shqiptarë të cilët kishin kontribuar në sistemin jugosllav nuk mund të përfitonin më pensione nga fondi që ishte mbledhur ngase Serbia këtë fond e kishte bartur dhunshëm në Serbi.

<b>•ETAPA E PARË (1947-1983):</b>	Ligjet e ish-Federatës Jugosllave aplikuar në Kosovë.
<b>•ETAPA E DYTË (1983-1992):</b>	Kosova kishte sistem pensional autonom, rregulluar nga ligjet e Kuvendit të Kosovës.
<b>•ETAPA E TRETË (1992-1999):</b>	Sistemi pensional i Kosovës integrohet dhunshëm në atë të Serbisë me ligje diskriminuese.
<b>•ETAPA E KATËRT (1999-2002):</b>	"Vakum institucional dhe ligjor" për shkak të luftës; sistemi pensional nuk funksionoi.
<b>•ETAPA E PESTË (2002 E TUTJE):</b>	Reforma në sistemin pensional dhe invalidor, e përbërë nga tri shtylla kryesore dhe skema të tjera të veçanta.

*Treguesi nr. 1. Pesë Etapat e Sistemit Pensional të Kosovës*

---

[1] Kushtetuta e vitit 1974 e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë, Ligji i vitit 1982 i RSFJ-së mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor dhe Ligji i vitit 1983 të KSAK mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor.

### 3. Administrimi ndërkombëtar i pensioneve dhe periudha pas shpalljes së Pavarësisë

Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, vendi u vendos nën administrimin ndërkombëtar të UNMIK-ut (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë), i cili kishte për detyrë të ndihmonte në ndërtimin e strukturave të reja dhe stabilizimin e sistemit shoqëror të vendit.

Një nga sfidat kryesore të këtij misioni ishte menaxhimi i sistemit të pensioneve. UNMIK-u ndërmori hapa për të themeluar një sistem të ri pensional që do të sigurote mbështetje të qëndrueshme dhe të besueshme për pensionistët dhe ata që ishin në prag të daljes në pension. Ky sistem i ri u krijua në përputhje me Rregulloren Nr. 2001/35 të UNMIK-ut[2] dhe synonte të ofronte një strukturë të organizuar dhe funksionale për përfitimet pensionale. Në vitin 2002, sistemi i ri pensional u operacionalizua. Përmes këtij reformimi, UNMIK-u ndihmoi në krijimin e një baze më të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe strukturave pensionale në Kosovë. Si rezultat, sistemi pensional në Kosovë u organizua në katër shtylla:

#### SHTYLLA I

**E financuar nga shteti: Pensionet bazë dhe pensionet e aftësisë së kufizuar**

Pensionet bazë dhe pensionet e aftësisë së kufizuar;

#### SHTYLLA III

**Vullnetare**

Për ata që dëshirojnë të kontribuojnë më shumë

#### SHTYLLA II

**Pensionet e obliguara**

Për të gjithë punëtorët e Kosovës, me kontribut të përcaktuar

#### SHTYLLA IV

**Skemat e veçanta**

Skema dhe nënskema pensionale

**Treguesi nr. 2.** Sistemi Pensional i Kosovës: Shtyllat Kryesore dhe Skemat Shtesë

Pensionistët në Kosovë përfitojnë një pension të bazuar në moshë, i cili ofrohet pavarësisht nëse individët kanë qenë të punësuar në të kaluarën apo jo. Ky sistem i pensioneve, i financuar plotësisht nga buxheti i shtetit, u vendos në vitin 2002 si një masë për të lehtësuar varfërinë, duke funksionuar më shumë si një ndihmë sociale se sa si një përfitim tradicional i pensioneve. Në atë kohë, Kuvendi miratoi një ligj të veçantë që përcaktonte mënyrën e llogaritjes së pensionit të bazuar, duke e bërë Ministrinë e Financave përgjegjëse për vlerësimin e shpenzimeve mesatare mujore për shportën ushqimore që përmbush standardet minimale të kalorisë.

Ky ligj përcaktonte që pensioni i bazës të mbështetet në nevojat ushqimore minimale për një

---

[2] Rregullore Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë; Misioni Ndërkombëtar i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; (Shih linkun:

[https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/O3albanian/A2001regs/RA2001\\_35.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/O3albanian/A2001regs/RA2001_35.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

individ, duke përdorur një vlerë referuese prej 2.100 kalori në ditë. Ministria e Financave ishte e ngarkuar me përlogaritjen e shpenzimeve për këtë shportë ushqimore, duke siguruar që ajo të përfshinte artikujt ushqimorë dhe vlerat e nevojshme në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo skemë synonte të ofronte një nivel të caktuar mbështetje për pensionistët dhe të ndihmonte në uljen e varfërisë në vend.

Në këtë mënyrë, politika e pensioneve e vendosur gjatë qeverisjes nën administrimin ndërkombëtar të UN-it dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, ofronte një formë mbështetjeje për të moshuarit në Kosovë, duke i siguruar ata me një ndihmë të nevojshme që i ndihmonte të përballonin shpenzimet e përditshme dhe të kishin një standard të pranueshëm të jetesës, pavarësisht nga historia e tyre e punësimit.

Aplikimi i këtij ligji ishte bërë në vitin 2002, ku pensioni i parë bazë për të moshuarit ishte përcaktuar në shumën prej 28 euro.[3] Ligji ishte zbatuar edhe në vitet vijuese, për vitin 2003 shuma ishte llogaritur 35 euro, për vitin 2004 prej 40 euro dhe për vitin 2005 Qeveria kishte përcaktuar lartësinë prej 45 euro.

- **28 euro** në vitin 2002
- **35 euro** në vitin 2003
- **40 euro** në vitin 2004
- **45 euro** për vitin 2005

**Treguesi nr. 3**, Rritja e Pensioneve bazike në Kosovë: 2002-2005

Për vitet pasuese: 2006, 2007 dhe 2008 Qeveria nuk kishte zbatuar ligjin ku obligohej të përlogariste koston e jetesës dhe ta përshtaste me pensionin bazë. Ndërsa, në vitin 2009, në mënyrë ad-hoc dhe pa asnjë vlerësim në pajtim me Ligjin nr. 2002/1 mbi Metodologjinë e Caktimit të Lartësië së Pensionit Bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e Pensionit Bazë, kishte rritur pensionet bazike për 12.5%.

Situatë e njejtë ishte edhe në vitin 2012 ku pensionet u rritën për 33.3%, dhe në vitin 2013 po ashtu pa ndonjë vlerësim dhe harmonizim me koston e jetesës.[4]

---

[3] *Ligji nr. 2002/1 mbi Metodologjinë e Caktimit të Lartësië së Pensionit Bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e Pensionit Bazë*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2427>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[4] *Rriten pensionet*; Kosovapress; (Shih linkun: [https://www.youtube.com/watch?v=IN6D2Gx\\_J\\_k](https://www.youtube.com/watch?v=IN6D2Gx_J_k)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

- nga **45 euro** u bënë 65 euro për vitin 2013
- nga **65 euro** u bënë 75 euro për vitin 2014

**Treguesi nr. 4**, Rritja e Pensioneve bazike në Kosovë: 2013-2014

Rritje të pensioneve nuk pati për katër vitet e tjera, shuma prej 75 euro aq sa u rritë në vitin 2014, mbeti e tillë deri në vitin 2019.

- **75 euro** për vitin 2015
- **75 euro** për vitin 2016
- **75 euro** për vitin 2017
- **75 euro** për vitin 2018

**Treguesi nr. 5**, Niveli e Pensioneve bazike në Kosovë: 2015-2018

Rritja e pensioneve u bë për vitin 2019, edhe këtu me vendim ad hoc, pa analizë në pajtim me ligjet përkatëse.[5] Rritja u bë nga 75 në 90 euro, në ndërkohë nuk pati asnjë rritje tjetër për vitin 2020 dhe 21.

Me 12 janar 2022, Qeveria e Kosovës mori vendim që asnjë pension nuk do të jetë nën 100 euro. Pensionet bazike që kishin vlerën 90 euro, pensionet e aftësisë së kufizuar 75 euro, pensioni familjar 90, dhe pensioni invalidor i punës 90 euro u bënë të gjitha 100 euro.[6] Me këtë vendim, duke filluar nga shkurti 2022, data e pagesës së pensioneve do të bëhej në mes të muajit, me qëllim, siç thuhej në komunikatën e Qeverisë së Kosovës, që familjet përfituese të kenë më shumë lehtësi në menaxhimin e buxhetit të tyre familjar.

- nga **90 në 100 euro** pensionet bazike
- nga **75 në 100 euro** pensionet e aftësisë së kufizuar
- nga **90 në 100 euro** pensioni familjar
- nga **90 në 100 euro** pensioni invalidor i punës

**Treguesi nr. 6**, Rritja e Pensioneve bazike dhe me aftësi të kufizuara në Kosovë: 2022-2024

[5] *Vendimi nr. 03/90 i Qeverisë së Kosovës*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62757>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[6] *Vendimi nr. 05/54 i Qeverisë së Kosovës*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51960>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Në vitet e tjera pasuese (2023 dhe 2024), Qeveria nuk ndërmori asnjë vendim tjetër që do të bënte përpjekje që t'i harmonizojë me koston e jetesës shumë të pensioneve. Përveç që në vitin 2023, ku Qeveria Kurti 2 transferoi nga 100 euro për të gjithë pensionistët, por sërish në kundërshtim me Ligjin për Skemat Pensionale[7] dhe me Ligjin mbi përcaktimin e lartësisë së pensionit. Vendimi u morr në kuadër të zbatimit të masës 3.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.[8]

- **100 euro** për vitin 2023
- **100 euro** deri në muajin tetor 2024

**Treguesi nr. 7.** Niveli i Pensioneve bazike dhe me aftësi të kufizuara në Kosovë: 2023-2024

Siç do të elaborohet në kapitullin "Ngritja e vonshme dhe e pamjaftueshme e shumës së pensioneve", më 7 tetor 2024, Kryeministri i Kosovës dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve njoftuan se pensioni bazik i moshës do të rritet përr 20 euro, duke filluar nga muaji tetor i vitit 2024. Ndërsa, aktualisht në Kosovë, pensionin bazik prej 100 euro e marrin 149,504 pensionistë. Ndërsa, mbi 48 mijë janë pensionistë kontributpagues. Po ashtu, 20 individë përfitojnë pensione për aftësi të kufizuara, 1,849 pensionistë janë të regjistruar në skemat për të verbërit, 2,878 përfitojnë pensione familjare, dhe 3,021 marrin pensione për paraplegjikë dhe tetraplegjikë. [9]

## 4. Mbrojtja sociale e pensionistëve sipas Kushtetutës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dy dispozita të rëndësishme që flasin për të drejtën e mbrojtjes sociale.[10] Neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është njëra prej dispozitave kyçe që mbrojtjen sociale dhe mirëqenien e individëve që kanë arritur në moshën e pensionit e lidhë me miratimin e ligjeve specifike.

Kushtetuta autorizon Ligjin për të rregulluar çështjet që lidhen me mbrojtjen sociale, duke e deleguar këtë detyrë në legjislaturën përkatëse. Megjithatë, ajo nuk përmban norma të tjera të detajuara që specifikojnë në mënyrë të hollësishme mënyrën e zbatimit të këtyre parimeve. Kjo qasje e kushtetutës nuk nënkupton se përfshirja e drejtësisë sociale si një vlerë kushtetuese dhe mundësia për krijimin e një ligji për të trajtuar çështjet sociale janë të paefektshme.

Në fakt, ky rregullim është në përputhje me qëllimin e Kushtetutës, e cila ka për qëllim të sigurojë një bazë të fortë për drejtësinë sociale, edhe në mungesë të detajeve specifike. Përcaktimi i drejtësisë sociale si një vlerë kushtetuese dhe mundësia për të krijuar ligje që adresojnë çështjet sociale janë mënyra për të siguruar që parimet e drejtësisë dhe barazisë të mbeten në qendër të

[7] Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[8] Vendimi nr. 43/178 i Qeverisë së Kosovës; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84703>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[9] Statistikat e Mirëqenies Sociale, Qershor 2024; Agjencia e Statistikave të Kosovës; (Shih linkun: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/e00ab999-87dd-4511-b86d-d84f1999f666.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[10] Neni 7 dhe 51 i Kushtetutës së Kosovës; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

të sistemit ligjor, duke lejuar që ligji të zhvillohet dhe të përshtatet sipas nevojave dhe sfidave të shoqërisë.

Në nivelin ligjor, dispozita kushtetuese për mbrojtjen sociale është e lidhur ngushtë me legjislationin e posaçëm që rregullon këto çështje. Ligjet dhe politikat e hartuara për të mbështetur mbrojtjen sociale duhet të jenë në përputhje me parimet e garantuara nga Kushtetuta, Neni 7. Kjo përfshin krijimin e strukturave dhe procedurave që e bëjnë të mundur realizimin e të drejtave dhe mbrojtjes sociale në mënyrë të efektshme dhe të drejtë për të gjithë qytetarët. Ligji nr. 2002/1 mbi Metodologjinë e Caktimit të Lartësië së Pensionit Bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e Pensionit Bazë dhe Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti e përmbushin këtë kërkesë të Nenit 51 të Kushtetutës së Kosovës, por që efektiviteti i këtij ligji varet nga përkushtimi i vazhdueshëm për ta zbatuar këtë ligj nga pushteti politik ekzekutiv, në këtë rast Qeveria e Kosovës.[11]

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjen zbatim direkt në Kushtetutë, thotë që se secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë për sigurim social, të drejtën për atë standard jetësor i cili atij dhe familjes së tij i siguron shëndet dhe mirëqenie, (duke përfshirë ushqimin, veshjen, banesën, përkujdesjen mjekësore dhe nevojat e shërbimit social), si dhe të drejtën e sigurimit në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësimi, pleqërisë dhe në raste të tjera të humbjes së mjeteve të jetesës, për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij.[12]

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), Pakti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Karta Sociale Evropiane, vazhdojnë të mos jenë pjesë e intrumenteve drejtpërdrejt të zbatueshme në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo gjendje mund të krijojë probleme ligjore në procesin e përpilimit të ligjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare. Poashtu Kosova vazhdon të mbetet ndër vendet e pakta në Evropë që nuk është pjesë e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore. Kjo është konsideruar si ndër të metat themelore të sistemit tonë kushtetues në fushën e të drejtave të njeriut, përveç nga shoqëria civile, poashtu edhe nga qeveria e Republikës së Kosovës në Programin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut 2021-2023.[13]

---

[11] Ligji nr. 2002/1 mbi Metodologjinë e Caktimit të Lartësië së Pensionit Bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e Pensionit Bazë; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2427>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[12] Neni 22 dhe 25; "Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut"; Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara; 10 dhjetor 1948; (Shih linkun: [https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)), Qasur për herë të fundit më 29.08.2024.

[13] Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; Zyra e Kryeministrit; (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/SHQIP-PROGRAMI-PER-MBROJTJEN-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT-2021-2023.pdf>), Qasur për herë të fundit më: 29.08.2024

## 5. Jeta e dinjitetshme e pensionistëve - obligim shtetëror

Në çdo shoqëri, siguria financiare e pensionistëve është një element i rëndësishëm për ruajtjen e dinjitetit dhe cilësisë së jetës së të moshuarve. Pensionistët, që shpesh kanë kaluar dekada duke kontribuar në ekonominë dhe shoqërinë e tyre, përballen me sfida të shumta kur arrijnë në fazën e pensionimit. Këto sfida janë shpesh të ndërlikuara nga ndryshimet demografike dhe krizave ekonomike. Prandaj, është detyrë e domosdoshme e shtetit që të sigurojë të ardhura të mjaftueshme për pensionistët, në mënyrë që ata të mund të jetojnë një jetë të dinjitetshme dhe të plotë.

Roli i shtetit në sigurimin e të ardhurave për pensionistët është shumëdimensional dhe përfshin një sërë politikash dhe strategjishë. Në shumicën e shteteve evropiane, shteti është përgjegjës për krijimin e një sistemi të pensioneve që siguron një nivel minimal të të ardhurave për individët që kanë arritur moshën e pensionit. Ky sistem zakonisht përfshin pensionet kombëtare ose shtetërore, të cilat ofrojnë mbështetje financiare për të gjithë individët që kanë kontribuar gjatë jetës së tyre në formën e tatimeve ose kontributeve për sigurimet shoqërore.

Përveç pensioneve kombëtare, shumë shtete kanë ndërtuar politika të ndryshme për të mbështetur pensionistët, të tilla si ndihmat sociale dhe subvencionet për shërbime të rëndësishme si shëndetësia dhe strehimi. Këto masa ndihmojnë për të mbuluar nevojat e tjera të pensionistëve dhe për të siguruar që ata të mund të jetojnë në kushte të mira.[14]

Përveç kësaj, ndihmat dhe pensionet shpesh janë të ndryshme për grupe të ndryshme të pensionistëve. Disa individë që kanë kontribuar më shumë gjatë karrierës së tyre mund të marrin pensione më të larta, ndërsa të tjerë, që kanë kontribuar më pak ose kanë punuar në sektorë të pakësuar, mund të marrin pensione më të ulëta. Kjo shpesh krijon një diferencë të madhe në cilësinë e jetës së pensionistëve, dhe mund të çojë në situata të vështira për ata që janë më të pafavorizuar.

Për të përmirësuar sistemin e pensioneve dhe për të siguruar që pensionistët të kenë të ardhura të mjaftueshme, janë të nevojshme reforma dhe strategji të ndryshme. Një qasje e mundshme është rritja e kontributit nga individët gjatë periudhës së tyre aktive, e kombinuar me përmirësimin e menaxhimit të fondeve të pensioneve për të siguruar një përdorim më efikas të burimeve. Kjo mund të përfshijë një rritje të përkohshme të kontributeve ose zbatimin e një sistemi të ndryshëm të sigurimeve që ndihmon në mbështetje të përhershme.

---

[14] Mbështetje për të moshuarit; Autoriteti i Pensioneve në Suedi; (Shih linkun: <https://www.pensionsmyndigheten.se/for-pensionarer/ekonomiskt-stod/ansok-om-aldreforsorjningsstod#:~:text=%C3%84ldref%C3%B6rs%C3%B6rjningsst%C3%B6det%20%C3%A4r%20ett%20st%C3%B6d%20f%C3%B6r,samma%20ans%C3%B6kan%20som%20f%C3%B6r%20bostadstill%C3%A4gg>). (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Një tjetër mundësi është përmirësimi i strukturës së pensioneve për të adresuar pabarazitë ekzistuese. Kjo mund të përfshijë krijimin e një sistemi më të barabartë që ofron mbështetje më të madhe për individët që kanë kontribuar më pak, si dhe për ata që kanë përjetuar periudha të papunësisë ose papërshtatshmërisë në periudha të ndryshme.

Kur shteti nuk ka mundësi të rrisë pensionet, ka disa masa dhe politika alternative që mund të ndihmojnë pensionistët për të mbuluar nevojat e tyre të përditshme. Ofrimi i subvencioneve për energjinë është një nga masat më të zakonshme, që ndihmon pensionistët të përballojnë kostot e energjisë, përfshirë dritat dhe ngrohjen. Gjithashtu, ndihma për shërbime shëndetësore është një masë tjetër e rëndësishme, e cila përfshin mbulimin e shpenzimeve për medikamente dhe trajtime mjekësore.

Në disa raste, mund të ofrohet mbështetje për kujdesin afatgjatë, duke ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për institucionet e përkujdesit ose shërbime të tjera të kujdesit. Po ashtu, ndihma për renovimin e shtëpive është një masë që ndihmon pensionistët me nevoja të veçanta, si dhe ndihma për pagesat e qirasë dhe bonuset për festat. Mund të ofrohet gjithashtu ndihmë për transport, për të lehtësuar lëvizjen dhe qasjen në shërbime të rëndësishme për pensionistët.

Siguria financiare e pensionistëve është obligim i shtetit dhe një tregues i nivelit të zhvillimit dhe mirëqenies së një kategorie të shoqërisë. Për të siguruar që pensionistët të kenë mundësi të zhvillojnë jetë të dinjitetshme, është e domosdoshme që shteti të implementojë politika të qëndrueshme dhe të drejtë për mbështetje financiare. Sfida të ndryshme, përfshirë ndryshimet demografike dhe problemet ekonomike, kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe reforma të vazhdueshme për të ruajtur një sistem të drejtë dhe të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, mund të sigurojmë që të gjithë individët që kanë kontribuar në shoqëri të kenë mundësinë për të jetuar në kushte të dinjitetshme dhe për të ndjerë se kontributet e tyre janë vlerësuar dhe respektuar.

## **6. Parimet dhe standardet ndërkombëtare mbi pensionet**

Të drejtat sociale janë krijuar dhe miratuar për të mbrojtur individët nga rreziku dhe për të siguruar një jetë të dinjitetshme për qytetarët e një shoqërie. Historikisht, këto të drejta kanë evoluar për t'i adresuar nevojat dhe sfidat që individët mund të përballen gjatë jetës së tyre. Në periudha të ndryshme të historisë, si gjatë industrializimit dhe pas Luftës së Dytë Botërore, është rritur ndërgjegjësimi për nevojën e mbrojtjes sociale, çka ka sjellë formimin e politikave të tilla.



Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara, miratuar në vitin 1948, e njeh të drejtën për punë, mbrojtjen sociale dhe standardet e jetesës, dhe ka ndihmuar në formimin e një kuadri ndërkombëtar për të drejtat sociale.[15] Po ashtu, Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës e vitit 1961[16] (e rishikuar) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore[17] kanë kontribuar në përcaktimin e drejtave sociale dhe në garantimin e mbrojtjes për individët.

Konventa Nr. 102 për Standardet Minimale të Sigurimeve Sociale[18] përcakton standardet minimale për sigurimet sociale, duke përfshirë pensionet e pleqërisë dhe përfitimet e tjera sociale. Ajo kërkon që shtetet të sigurojnë që përfitimet të përshtaten për të mbrojtur përfituesit nga humbja e vlerës reale të të ardhurave për shkak të inflacionit.

Konventa Nr. 128 për Pensionet e Invaliditetit, Pleqërisë dhe të Mbijetuarve[19] (1967) përcakton standardet për skemat e pensioneve për këto kategori dhe thekson nevojën për përfitime të mjaftueshme dhe mbrojtje nga humbja e fuqisë blerëse.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), Neni 1 i Protokollit të Parë garanton të drejtën e pronës, dhe kjo mund të përfshijë përfitimet e sigurimeve sociale, përfshirë pensionet. Në rastin e dështimit të shtetit për të harmonizuar pensionet me koston e jetesës, mund të lindin çështje që lidhen me të drejtën për të pasur të ardhura të mjaftueshme.

Kodi Evropian i Sigurimeve Sociale[20] (1964), është pjesë e përpjekjeve të Këshillit të Evropës për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat sociale, përfshirë pensionet dhe përfitimet e pleqërisë.

Rekomandimet e BE-së për pensionet adekuate, të qëndrueshme dhe të sigurta theksojnë nevojën për skema pensionale që të jenë të harmonizuara me koston e jetesës dhe të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për përfituesit.

---

[15] Neni 25, *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara*; Kombet e Bashkuara; (Shih linkun: <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[16] *Pjesa I, par. 23, Neni 13 dhe 23, Karta Sociale Evropiane* (e rishikuar); Këshilli i Evropës; (Shih linkun: <https://rm.coe.int/168047e169>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[17] *Neni 9, 11 dhe 12, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*; Kombet e Bashkuara; (Shih linkun: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-economic-social-and-cultural-rights>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[18] *Neni 26, 29 dhe 30, Konventa Nr. 102 për Standardet Minimale të Sigurimeve Sociale*; Organizata Ndërkombëtare e Punës; (Shih linkun: <https://www.ilo.org/publications/c102-social-security-minimum-standards-convention-1952>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[19] *Neni 15, 16, 17 dhe 18, Konventa Nr. 128 për Pensionet e Invaliditetit, Pleqërisë dhe të Mbijetuarve*; Organizata Ndërkombëtare e Punës; (Shih linkun: [https://normlex.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100\\_ILO\\_CODE:C128](https://normlex.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C128)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[20] *Kodi Evropian i Sigurimeve Sociale*; Këshilli i Evropës (Shih linkun: <https://rm.coe.int/168006b65e>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Parimi 15 i Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale trajton "Të ardhurat e moshës së tretë dhe pensionet".[21] Ky parim ka për qëllim të sigurojë që individët që janë në moshën e pensionit të kenë një nivel të mjaftueshëm të të ardhurave për të mbajtur një jetë dinjitoze. Sipas këtij parimi, shtetet anëtare duhet të ofrojnë mbështetje financiare për ata që kanë dalë në pension, duke garantuar që pensionet të jenë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat themelore dhe për të siguruar një standard të mirë jetese.

Një pjesë kyçe e këtij parimi është që sistemet e pensioneve duhet të jenë të qëndrueshme dhe të ofrojnë një mbrojtje të duhur për ata që janë në moshën e pensionit. Kjo përfshin jo vetëm sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të të ardhurave për individët që kanë arritur moshën e pensionit, por edhe mbrojtjen ndaj rreziqeve të tjera që mund të ndikojnë në mirëqenien e tyre. Për të siguruar që ky parim të zbatohet në praktikë, shtetet duhet të krijojnë dhe të mbajnë sisteme të sigurimeve sociale që ofrojnë mbështetje të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për pensionistët. Këto sisteme duhet të jenë të dizajnuara për të mbuluar nevojat financiare të individëve dhe për të siguruar që ata të kenë qasje në shërbime të nevojshme dhe ndihmë të tjera për të mbajtur një standard të përshtatshëm të jetesës.

## 7. Praktikrat ndërkombëtare të rregullimit të pensioneve

Pensionet përbëjnë një pjesë thelbësore të sistemit të sigurisë sociale të një shteti dhe janë krijuar për të siguruar mbështetje financiare për individët që kanë arritur moshën e daljes në pension, kanë përjetuar paaftësi për punë, ose kanë mbetur pa mbështetje familjare. Sistemet e pensioneve variojnë në mënyrën e organizimit, financimit dhe menaxhimit të tyre, duke reflektuar politikat specifike të secilit shtet.

Rregullimi ligjor i pensioneve ndryshon në varësi të vendit dhe përfshin një sërë ligjesh, rregullash dhe politikash që përcaktojnë mënyrën e funksionimit të sistemeve të pensioneve.

Mosha e daljes në pension përbën një element i cili përfshihet në rregullimin ligjor të shteteve lidhur me pensionet. Mosha e daljes në pension është një çështje e rëndësishme politike dhe ekonomike që reflekton prioritetet e ndryshme sociale dhe ekonomike të secilit shtet. Ndryshimet demografike dhe ekonomike po detyrojnë shumë vende të rishikojnë dhe reformojnë politikat e tyre të pensioneve për të siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe për të garantuar mbështetje adekuate për të moshuarit. Ligjet e pensioneve zakonisht përcaktojnë një moshë të caktuar për daljen në pension. Kjo moshë mund të ndryshojë në varësi të shtetit.

---

[21] Parimi 15, Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale në 20 parime; Komisioni Evropian; (Shih linkun:

[https://ec.europa.eu/social/main.jsp?](https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1606&langId=en#:~:text=15.,opportunities%20to%20acquire%20pension%20rights)

[catId=1606&langId=en#:~:text=15.,opportunities%20to%20acquire%20pension%20rights](https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1606&langId=en#:~:text=15.,opportunities%20to%20acquire%20pension%20rights)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Në Gjermani, mosha standarde e daljes në pension është 67 vjeç për burrat dhe gratë. Gjermania ka një sistem të mirë-përcaktuar të pensioneve të bazuar në kontributet e punonjësve dhe punëdhënësve. Për ata që kanë punuar për një periudhë të gjatë dhe kanë arritur një numër të caktuar vitësh të sigurimeve shoqërore, mund të ketë mundësi për të dalë në pension në moshë më të hershme, por me një reduktim të përfitimeve. Gjithashtu për secilin person të lindur pas datës 1 Janar 1964, aplikohet mosha 67 vjeçare si moshë e daljes në pension.[22]

Në Francë, mosha e daljes në pension është aktualisht 62 vjeç për burrat dhe gratë, por me një minimum prej 42 vite pune për të marrë përfitimet e plota. Franca ka pasur diskutime të vazhdueshme dhe protesta lidhur me reformimin e sistemit të pensioneve[23], përfshirë rritjen e moshës së daljes në pension dhe periudhën e kontributit për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të sistemit.[24]

Në SHBA, mosha e plotë e daljes në pension për përfitimet e sigurimeve shoqërore është 66 vjeç e 2 muaj për ata të lindur midis viteve 1955 dhe 1959 dhe 67 vjeç për ata të lindur në vitin 1960 dhe më vonë. Megjithatë, individët mund të zgjedhin të dalin në pension që në moshën 62 vjeç me përfitime të reduktuara. Ka gjithashtu mundësi për të rritur përfitimet nëse individët presin të dalin në pension deri në moshën 70 vjeç.[25]

Italia ka ndryshuar politikën e saj të pensioneve disa herë në vitet e fundit për shkak të presioneve ekonomike dhe të qëndrueshmërisë financiare. Aktualisht, mosha e daljes në pension është 67 vjeç, megjithatë, ka mundësi për të dalë në pension më herët nëse individët kanë kontribuar për një periudhë të gjatë (40-42 vjet për burrat dhe 41-42 vjet për gratë). Italia ka një sistem fleksibël që merr në konsideratë një kombinim të moshës dhe periudhës së kontributit.[26]

Japonia, një nga vendet me popullsinë më të moshuar në botë, ka vendosur një moshë të daljes në pension prej 65 vjeç për burrat dhe gratë.[27] Megjithatë, ekziston një debat i vazhdueshëm

---

[22] *Germany - Pensions and other old age benefits*; European Commission; (Shih linkun:

<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1111&intPageId=4554&langId=en>), (Qasur për herë të fundit më 01.09.2024)

[23] *French left, labour unions stage new day of protests against pension reform*; France 24; (Shih linkun:

<https://www.france24.com/en/europe/20230606-protesters-prepare-for-14th-day-of-protests-in-bid-to-stop-french-pension-overhaul>), (Qasur për herë të fundit më: 01.09.2024)

[24] *The French Social Security System III-Retirement*; Cleiss; (Shih linkun:

[https://www.cleiss.fr/docs/regimes/regime\\_france/an\\_3.html#:~:text=Whatever%20the%20circumstances%2C%20the%20minimum,1%2C932%20per%20month%20in%202024](https://www.cleiss.fr/docs/regimes/regime_france/an_3.html#:~:text=Whatever%20the%20circumstances%2C%20the%20minimum,1%2C932%20per%20month%20in%202024)), (Qasur për herë të fundit më: 02.09.2024)

[25] *Employee Retirement Income Security Act of 1974 (ERISA)*, (Public Law 93-406), As Amended Through P.L. 117-328,

Enacted December 29, 2022; (Shih linkun: <https://www.govinfo.gov/content/pkg/COMPS-896/pdf/COMPS-896.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 09.03.2024)

[26] *Pensions in Italy*; (Shih linkun: <https://www.expatica.com/it/finance/retirement/pension-in-italy-82946/>), (Qasur për herë të fundit më 30 Gusht 2024).

[27] *National Pension System; Japan Pension Service*; (Shih linkun: <https://www.nenkin.go.jp/international/japanese-system/nationalpension/nationalpension.html#:~:text=The%20pensionable%20age%20for%20the,start%20to%20receive%20your%20pension>), (Qasur për herë të fundit më 30 Gusht 2024).

për rritjen e moshës së daljes në pension deri në 70 vjeç për të përballuar sfidat demografike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve.[28]

Në Mbretërinë e Bashkuar, mosha e daljes në pension është 66 vjeç për burrat dhe gratë, e cila do të rritet në 67 vjeç midis viteve 2026 dhe 2028. Si në shumë vende të tjera, mosha e daljes në pension është rritur për shkak të rritjes së jetëgjatësisë dhe sfidave të qëndrueshmërisë financiare.[29]

Poashtu, pensionet rregullohen nga disa ligje dhe rregullore që ndryshojnë dukshëm nga një vend në tjetrin. Këto rregullime ligjore janë krijuar për të siguruar që pensionet të janë të drejta, të arsyeshme, të qëndrueshme dhe përshtatshme me koston e jetesës dhe inflacionin.

Qasja e çdo vendi për rregullimin e pagesave të pensioneve pasqyron kushtet unike ekonomike, dhe politikat sociale. Trajtimet në këto rregullore përfshijnë përpjekjet për të mbrojtur fuqinë blerëse të pensionistëve, për të promovuar drejtësinë dhe qëndrueshmërinë dhe për t'u përshtatur me ndryshimin e kushteve ekonomike dhe inflacionit të mundshëm. Këto ligje rishikohen dhe rregullohen vazhdimisht për të siguruar që vlera e pensioneve të mbetet e fuqishme dhe të përshtatet me kushtet e jetesës të secilit shtet.

Në Mbretërinë e Bashkuar ekziston një mekanizëm i quajtur "Triple Lock Mechanism", i cili garanton që pensioni shtetëror do të rritet çdo vit duke u bazuar në tri masa: rritja mesatare e të ardhurave, inflacioni (i matur me Indeks të Konsumit) ose 2.5%. Kjo politikë siguron që të ardhurat e pensionistëve të rriten në terma real dhe të mbajnë ritmin me rritjen e kostove të jetesës.[30]

Vlera e pensioneve në Kanadë rregullohet poashtu çdo vit, bazuar në Indeks të Konsumit (CPI) për të mbrojtur kundër inflacionit. Kjo siguron që pensionistët të ruajnë fuqinë e tyre blerëse me kalimin e kohës, duke parandaluar një rënie të standardit të tyre të jetesës për shkak të rritjes së çmimeve.[31]

---

[28] *GMeiji Yasuda Life to extend retirement age to 70 amid labor shortage*; (Shih linkun: <https://english.kyodonews.net/news/2024/07/3d78f7f30efb-meiji-yasuda-life-to-extend-retirement-age-to-70-amid-labor-shortage.html#:~:text=Meiji%20Yasuda%20Life%20Insurance%20Co,with%20the%20matter%20said%20Monday>), (Qasur për herë të fundit më 31 Gusht 2024).

[29] *State pension age timeables*; Gov, UK; (Shih linkun: <https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5a7f02e640f0b62305b84929/spa-timetable.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 01.09.2024).

[30] *What is the triple lock pension and how does it affect me?*; Unbiased; (Shih linkun: <https://www.unbiased.co.uk/discover/pensions-retirement/managing-a-pension/what-is-the-triple-lock-pension-and-how-does-it-affect-me>), (Qasur për herë të fundit më 02.09.2024).

[31] *Canada Pension Plan amounts and the Consumer price index*; Government of Canada; (Shih linkun: <https://www.canada.ca/en/services/benefits/publicpensions/cpp/cpp-benefit/after-apply/consumer-price-index.html>), (Qasur për herë të fundit më 01.09.2024).

Politika e pensionit të pleqërisë në Holandë rregullohet nëpërmjet AOW (Algemene Ouderdomswet). Banorët e Holandës kanë të drejtë në pension, nëse kanë jetuar ose punuar në Holandë midis moshës 15 vjeçare dhe moshës së daljes në pension të rregulluar përmes AOW. Që nga viti 2024, mosha e daljes në pension AOW është 67 vjeç dhe kjo moshë është duke u ngritur gradualisht. Mosha rregullohet periodikisht në bazë të ndryshimeve përkitazi me jetëgjatësinë mesatare.[32] Shuma e pensionit (AOW) varet nga mënyra e jetesës. Psh, beqarët marrin një shumë më të lartë në krahasim me ata që jetojnë me një partner, pasi pensioni synohet të mbulojë kostot bazë të jetesës. Pensioni AOW rregullohet çdo vit në përputhje me inflacionin, duke siguruar që vlera e tij të ruhet me kalimin e kohës. Sistemi holandez i pensioneve është i njohur për qëndrueshmërinë e tij, duke kombinuar një pension bazë shtetëror me pensionet profesionale dhe private për të siguruar të ardhura gjithëpërfshirëse nga pensioni.

## **8. Premtimet elektorale për reformë pensionale të Lëvizjes VETËVENDOSJE!**

Në programin elektoral të Lëvizjes VETËVENDOSJE, që ishte prezantuar për zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, një nga premtimet kryesore ishte reforma e thellë në skemat pensionale. Ky premtim synonte jo vetëm përmirësimin e jetës së qytetarëve të moshuar, por edhe adresimin e një problemi madhor social: varfërinë e lartë ndër pensionistët. Qeveria e drejtuar nga VV-ja e bëri këtë reformë një prioritet qeveritar, duke e përfshirë në Programin Qeverisës 2021-2025[33], ku theksohej nevoja për një sistem më të drejtë dhe më të qëndrueshëm të pensioneve që të siguronte një jetë dinjitoze për të gjithë.

Programi i Qeverisë është dokument me të cilin qeveritë e përcjellin qëllimin e saj para qytetarëve të vendit, lidhur me qeverisjen e saj për mandatin në të cilin fiton besimin. Programi i Qeverisë tregon qëllimet dhe parimet që do të ndiqen përgjatë qeverisjes dhe veprimet që do të ndërmerren në të gjitha fushat për përmirësimin e gjendjes në vend.

Mirëpo, me gjithë deklaratat dhe zotimet për reforma, realiteti ka qenë krejt ndryshe. Në fund të vitit të katërt të qeverisjes, asgjë konkrete nuk është bërë për të përmbushur këtë premtim. Projektligjet që do të mund të fillonin procesin e reformimit të skemave pensionale kanë qenë vazhdimisht pjesë e programit legjislativ, por deri më sot nuk ka pasur asnjë hap konkret në drejtim të zbatimit të tyre.

Përveç premtimeve para marrjes së mandatit qeverisës, edhe gjatë qeverisjes partia në pushtet ka përmendur se pensionet janë e drejtë e jo lëmoshë, deklarim ky i cili është i vërtetë, mirëpo asnjëherë gjatë qeverisjes nuk është tentuar të realizohet. Poashtu një premtim tjetër gjatë

---

[32] *Old Age Pension (AOW)*; Netherlands Enterprise Agency, RVO; (Shih linkun: <https://business.gov.nl/regulation/pension/>), (Qasur për herë të fundit më: 01.09.2024).

[33] *Programi Qeverisës 2021-2025, fq. 11*; Zyra e Kryeministrit; (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

qeverisjes ishte edhe zotimi i kryeministrit lidhur me Reformën e Sistemit Pensional, për të cilën reformë ai thotë që këtë vit po planifikohet të fillohet edhe reformën e sistemit pensional, në mënyrë që të sigurohet sistem i drejtë dhe pension të dinjitetshëm për secilin pensionist që ka dhënë kontribut për vend. Sipas tij, për reformën pensionale ka nisur puna e shumë shpejtë ligjet do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Kosovës.[34]

Mungesa e reformave në sistemin pensional tregon dështimin e qeverisë në përmbushjen e një prej premtimeve më të rëndësishme elektorale. Kur një qeveri premtion ndryshime të mëdha dhe nuk arrin t'i realizojë ato, humb besimin e qytetarëve dhe përkeqëson imazhin e saj si udhëheqëse që synon ndryshime thelbësore. Ky mosveprim dërgon një mesazh të qartë: qeverisja nuk po i mban përgjegjësitë që ka marrë përsipër. Për një qeveri që premtion ndryshime dhe progres, mospërmbushja e reformave të premtuara tregon mungesë të vullnetit politik dhe planifikimit të duhur.

Një qeveri që nuk arrin të zbatojë premtimet e saj e gjen veten përballë kritikave të ashpra jo vetëm nga opozita, por edhe nga qytetarët e saj. Premtimet e pambajtura dëmtojnë kredibilitetin dhe përforcojnë perceptimin se politikat publike shpeshherë mbeten thjesht në letër. Për më tepër, vonesat dhe mungesa e veprimeve konkrete krijojnë një boshllëk të përgjegjësisë dhe rrisin ndjenjën e zhgënjimit të qytetarët që kanë pritur reforma që do të përmirësonin jetën e tyre.

Në thelb, mosrealizimi i reformës pensionale nuk është vetëm një dështim politik, por edhe një dështim moral. Ai reflekton neglizhencën ndaj një shtrese vulnerabël të shoqërisë, e cila meriton siguri dhe dinjitet në vitet e pleqërisë. Për një qeveri që ka premtuar ndryshime të thella, çdo vonesë dhe çdo dështim është një thirrje për përgjegjësi dhe përmbushje të zotimeve që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve.

## **9. Mos harmonizimi i pensioneve me kushtet e jetesës në Kosovë**

Qeveria e Kosovës ka dështuar të harmonizojë pensionet me koston e jetesës dhe inflacionin, duke cenuar të drejtat e qindra mijëra pensionistëve. Pavarësisht se qytetarët që kanë mbushur 65 vjeç kanë të drejtën e një pensioni bazë si një masë për zbutjen e varfërisë, kjo politikë nuk ka arritur të përmbushë qëllimin e saj. Përfituesit kanë përjetuar vështirësi ekonomike për shkak të shumave të pamjaftueshme të pensioneve që nuk mbulojnë as shpenzimet minimale të jetesës.

---

[34] Kurti premtion reformë të plotë pensionale; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/386694/kurti-premtion-reforme-te-plate-pensionale>). (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Institucionet e Kosovës, përfshirë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), nuk kanë zbatuar legjislacionin në fuqi që kërkon rritjen e pensioneve në bazë të kostos së jetesës dhe inflacionit. Sipas Ligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti dhe Ligjit për Metodologjinë e Caktimit të Lartësisë të Pensionit Bazë, është detyrim ligjor që MFPT të propozojë rritjen e pensioneve çdo fundvit, por ky detyrim nuk është përmbushur. Kjo mospërshtatje e pensioneve përbën një shkelje të drejtave të pensionistëve dhe një dështim të qeverisë për t'i mbrojtur ata.[35]

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në jetesën fillimisht të afërsisht 149 mijë pensionistëve, duke i lënë ata në prag të varfërisë. Shteti duhet të ofrojë kujdesin e nevojshëm shëndetësor, strehim dhe shërbime shtesë për të siguruar një standard të denjë jetese për këtë kategori.

Se është në dijeni Qeveria mbi kriteret që duhet përdorur për ta caktuar lartësinë e pensionit, kjo shihet edhe në dërgimin e komenteve të saj në drejtim të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO158/23, ku ajo argumenton se si qeveria me vendim të veçantë cakton lartësinë e pensioneve bazike në bazë të kriterëve ku përfshihet kostoja e jetës, mundësitë buxhetore dhe inflacioni eventual.[36]

Rritja e shpenzimeve për shkak të inflacionit ndikon ndjeshëm tek njerëzit që nuk shohin një rritje të ngjashme të të ardhurave të tyre. Kur të ardhurat nuk rriten me ritmin e nevojshëm për të mbuluar rritjen e kostove, individët përballen me vështirësi financiare. Kjo është veçanërisht e ndjeshme për ata që kanë burime të kufizuara të të ardhurave, sikurse pensionistët.

Për personat e moshuar, humbja e mundshme e fuqisë blerëse është e lidhur ngushtë me mekanizmat e indeksimit të pensioneve. Këta mekanizma janë të ndryshëm në çdo vend dhe ndikojnë në mënyrën se si pensionistët mbrohen nga inflacioni. Nëse këta mekanizma nuk janë të dizajnuar mirë ose nuk aplikohen në mënyrë efektive, pensionistët mund të përballen me humbje të konsiderueshme të fuqisë blerëse.[37] Për këtë arsye, indeksimi i shpeshtë është i nevojshëm për të ruajtur fuqinë blerëse të pensionistëve.[38]

## 10. Pensionet aktuale mirëmbajnë varfërinë

Siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe Ligji nr. 2002/1 për metodologjinë e përcaktimit të lartësisë së pensionit është hartuar me qëllim që të sigurojë përmirësimin e kushteve të jetesës për pensionistët, duke përfshirë rishikimin e pensioneve çdo vit në përputhje me koston e jetesës dhe inflacioni eventual. Megjithatë, të dy ligjet vazhdojnë të mbesin të paimplementuara për nevojat e pensionistëve. Ky mos-harmonizim ka pasoja të thella në jetën e përditshme të pensionistëve, duke kontribuar në varfëri të thelluar dhe izolim social.

---

[35] IKD: Shteti vazhdon t'i përjashtojë pensionistët duke mos i harmonizuar pensionet e me koston e jetesës siç ua garanton ligji; Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-shteti-vazhdon-ti-perjashtoje-pensionistet-duke-mos-i-harmonizuar-pensionet-e-me-koston-e-jeteses-sic-ua-garanton-ligji/>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[36] Aktgjykimi në rastin KO158/23; Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/ko\\_158\\_23\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/ko_158_23_agj_shq.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[37] OECD (2023); *Pensions at a Glance 2023: OECD and G20 Indicators*; OECD Publishing, Paris; (Shih linkun: <https://doi.org/10.1787/678055dd-en>), (Qasur për herë të fundit më: 31.08.2024).

[38] Po aty.

Mos-harmonizimi i pensioneve ka një ndikim të thellë në kushte të jetesës së pensionistëve në Kosovë. Pensionistët, që shpesh kanë një burim të vetëm të të ardhurave, janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në çmimet e jetesës dhe inflacionit. Shpenzimet për nevojat bazë, duke përfshirë gjërat ushqimore, transportin, shërbimet komunale, shëndetësinë, qiranë dhe shpenzimet e arsimit, janë rritur gjatë tre viteve radhazi (2021/2022/2023), gjë që kishte prekur në masë të madhe edhe pensionistët.[39]

Pensionistët, në shumicën e rasteve, janë të varur nga pensionet e tyre për të mbuluar shpenzimet për ushqim, strehim dhe shërbime të tjera të nevojshme. Kur këto pensione nuk rriten për të reflektuar ndryshimet në çmime dhe inflacion, pensionistët duhet të bëjnë sakrifica të mëdha në përpjekje për të mbuluar shpenzimet e përditshme. Kjo shpesh rezulton në kufizim të konsumit të ushqimit dhe reduktimin e shpenzimeve për shërbime të tjera esenciale, duke kontribuar në një përkeqësim të kushteve të jetesës.

Përveç të ardhurave më të ulëta, disa faktorë strukturorë kontribuojnë në ndikimin më të madh të inflacionit në kostot e jetesës për të moshuarit. Njëra nga këta faktorë është rritja e çmimeve të ushqimeve, e cila rëndon ndjeshëm buxhetet e të moshuarve.

Një ndikim tjetër i rëndësishëm është rritja e kostove të ngrohjes, që ndikon gjithashtu në mënyrë të veçantë tek ata që janë më të moshuar. Ky faktor kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në përkeqësimin e situatës financiare të tyre, duke e bërë më të vështirë përballimin e kostove të jetesës.[40]

Në vitin 2023, një rritje e ndjeshme e shpenzimeve për ushqim është vërejtur, ku 59.5% e ekonomive familjare shpenzuan 200 euro ose më shumë për këtë kategori, krahasuar me 38.8% në vitin 2021. Kjo rritje ndikon drejtpërdrejt në nivelin e varfërisë, i cili është vlerësuar në 16% për vitin 2023, një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2021. Inflacioni ka kontribuar në këtë situatë, duke bërë që një shtesë prej 10% e familjeve të jetojnë nën kufirin e varfërisë prej 1.85 euro në ditë.

Për më tepër, varfëria e thelluar ndikon në aspektet sociale të jetës së pensionistëve. Të moshuarit që janë të detyruar të jetojnë në kushte të vështira shpesh ndihen të izoluar dhe të braktisur, duke kontribuar në ndjenjat e dëshpërimit dhe depresionit. Këtë e vërteton edhe raporti i lartpërmendur i UNDP-së. Sipas këtij raporti, efekti i inflacionit është pasqyruar në

---

[39] *Shqyrtimi i Dinamikës së Varfërisë së Amvisërive Përballë Inflacionit*; UNDP; (Shih linkun: <https://www.undp.org/kosovo/publications/exploring-dynamics-household-poverty-face-inflation-evidence-survey>) (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

[40] OECD (2023); *Pensions at a Glance 2023: OECD and G20 Indicators*; OECD Publishing, Paris; (Shih linkun: <https://doi.org/10.1787/678055dd-en>), (Qasur për herë të fundit më: 31.08.2024).



cilësinë e jetës, me 46% të të anketuarve që raportuan një rritje të stresit dhe ankthit si rezultat i çmimeve më të larta. Rreth 69.2% e të anketuarve janë detyruar të përshtatin zakonet e tyre të shpenzimeve për të përballuar rritjen e kostove të jetesës, duke treguar se inflacioni ka ndikuar negativisht në mirëqenien sociale dhe mendore të individëve.

Një ndikim tjetër i rëndësishëm i mos-harmonizimit të pensioneve është kufizimi i aksesit në shërbime shëndetësore. Pensionistët që përballen me probleme financiare shpesh nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbime mjekësore dhe medikamente, duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve të mëdha për shëndetin e tyre. Kjo ndikon negativisht në cilësinë e jetës dhe mund të çojë në sëmundje më të rënda dhe kosto më të larta të trajtimit në të ardhmen.

Pensionet e ofruara aktualisht në Kosovë shpesh janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat themelore të pensionistëve. Kur pensionet nuk përputhen me ndryshimet në çmime dhe inflacion, ato kontribuojnë në ruajtjen e varfërisë. Në këtë seksion, do të shqyrtojmë se si pensionet aktuale ndihmojnë në ruajtjen e varfërisë dhe se si kjo ndikon në jetën e përditshme të pensionistëve.

## **11. Neglizhenca e Qeverisë i izolon të moshuarit**

Neglizhenca e qeverisë në implementimin e dy ligjeve për ta përcaktuar lartësinë e pensioneve dhe për të vendosur pension në pajtim me koston e jetesës dhe të inflacionit kontribuon në izolimin e të moshuarve dhe në përkeqësimin e kushteve të jetesës së tyre.

Jetesa në varfëri ka ndikim negativ në aspektet sociale dhe psikologjike të jetës së pensionistëve. Varfëria shpesh çon në izolim social, pasi pensionistët ndihen të turpëruar për të kërkuar ndihmë dhe shpesh ndihen të braktisur nga shoqëria. Kjo ndjenjë e izolimit dhe dëshpërimit ka efekte të mëdha në shëndetin mendor të pensionistëve dhe mund të përkeqësojë ndjenjat e depresionit dhe ankthit.

Pensionistët shpesh përballen me një nivel të lartë të marginalizimit në proceset politike dhe vendimmarrëse, dhe një faktor kyç që kontribuon në këtë marginalizim është mungesa e përfshirjes së tyre në dialogun social. Përfshirja e tyre në ndërtimin e politikave publike për çështjet pensionale nuk është vërejtur se ka ndodhur.

Mungesa e përfshirjes në dialogun social nënkupton që pensionistët nuk kanë mundësi të kontribuojnë në formësimin e politikave dhe ligjeve që ndiejnë drejtpërdrejt ata. Ky izolim i bën ata më të ndjeshëm ndaj vendimeve që i prekin, duke i lënë ata jashtë diskutimeve që ndihmojnë në përcaktimin e kushteve të tyre të jetesës.

Pensionistët që jetojnë në varfëri shpesh përballen me vështirësi edhe në qasjen e ndihmave sociale. Neglizhenca e qeverisë në ofrimin e mbështetjes adekuate dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për pensionistët kontribuon në ruajtjen e varfërisë dhe izolimin e tyre. Ndhimat sociale dhe programet e mbështetjes janë të rëndësishme për të ndihmuar pensionistët të përballojnë sfidat e jetës dhe për të siguruar një jetë më të dinjitetshme.

Në një periudhë të inflacionit të lartë dhe rritjes së kostove të jetesës, roli i qeverisë në menaxhimin e sistemit të pensioneve do të duhej të jetë i vëmendshëm për të siguruar mirëqenien e të moshuarve. Kur pensionet nuk rriten në përputhje me inflacionin dhe koston e jetesës, pasojat për të moshuarit janë të thella, duke përfshirë izolimin social të tyre.

Sipas një raporti të Bankës Botërore, të moshuarit që përballen me të ardhura të ulëta, siç janë pensionet që nuk janë të përshtatura për të përballuar rritjen e kostove, janë më të ndjeshëm ndaj izolimit social dhe varfërisë (World Bank, 2021). Kur pensionet nuk rriten për të mbuluar inflacionin, të moshuarit detyrohen të zvogëlojnë shpenzimet për nevoja themelore dhe të kufizojnë pjesëmarrjen në aktivitete sociale. Kjo situatë ndikon në cilësinë e jetës dhe ndihmon në krijimin e një spiraleje të izolimit dhe dëshpërimit.

Të moshuarit që përballen me vështirësi ekonomike janë më pak të prirur të marrin pjesë në aktivitete të komunitetit dhe kanë më shumë mundësi të ndjejnë se janë të shpërfillur nga shoqëria. Për më tepër, një raport nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ka theksuar se izolimi social ka ndikime negative në shëndetin mendor dhe fizik të të moshuarve. Mosveprimi për të mbajtur pensionet të përshtatshme për inflacionin rrit ndjeshëm rrezikun e depresionit dhe problemeve të tjera shëndetësore ndër të moshuarit.[41] Kur të moshuarit ndihen të lënë pas dhe të margjinalizuar, ata mund të ndiejnë se nuk kanë asnjë mbështetje të mjaftueshme dhe shpresë për të ardhmen.

## **12. Ngritja e vonshme dhe e pamjaftueshme e shumës së pensioneve**

Më 7 tetor 2024, kryeministri i Kosovës Albin Kurti, së bashku me Ministrin e Financave, Punëve dhe Transfereve, Hekuran Murati, në konferencë për medie, njoftuan se nga muaji tetor 2024[42] do të rriten disa kategori të pensioneve për 20%. Këtu përfshihet pensioni bazik i moshës, pensioni kontributpagues, i plotë dhe parcial, pensioni i aftësisë së kufizuar, për fëmijë dhe për të rritur, pensioni për personat e verbër, pensioni për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pensioni familjar, pensioni invalidor i punës dhe pensioni i parakohshëm për punëtorët e trepçës. Ndërsa, nga muaji janar i vitit 2025, u rritën për 20% pensionet e përcaktuara me ligjin për kategoritë e luftës, përkatësisht, familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve,

---

[41] "Social Isolation and Health in Older Adults"; World Health Organization (WHO); 2023.

[42] Postim në rrjetin social në facebook nga Kryeministri, Albin Kurti; (Shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/E1rBsTxWwnx1Kkkq/>). (Qasur për herë të fundit më 8 tetor 2024).

pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Duke mirëpritur çfarëdo rritje të pensioneve, kjo ngritje nuk abstrahon shkeljet e vazhdueshme të Qeverisë në raport me rritjen e pensioneve. Kjo masë, të cilës do duhej ti paraprinte një analizë e mirëfilltë, konsultime dhe shpjegime publike dhe që është dashur të ndodhte shumë më herët, pasi për vite me radhë pensionistët kanë përjetuar rënie të fuqisë blerëse dhe vështirësi në përmbushjen e nevojave bazike. Duke e realizuar këtë veprim pak kohë para zgjedhjeve, kjo ngritje ngjallë dyshime se një vendim i tillë bëhet për qëllime elektorale. Ky veprim është dashur të ndodhte si një reagim i natyrshëm ndaj përkeqësimit të standardit të jetesës të pensionisteve, duke ndjekur obligimet ligjore në Ligjin për Skemat Pensionale dhe jo si një vendim që ngjanë në një lëvizje politike, që synon mbështetje elektorale.

Kjo ngritje është bërë pa një analizë të mirëfilltë të kushteve aktuale të pensionistëve. Sipas ligjit, qeveria është e detyruar të kryejë një harmonizim të pensioneve me koston e jetesës çdo vit, por ky detyrim duket se është shpërfillur. Përpos që ky harmonizim nuk u bë në asnjë vit, rritja prej 20% erdhi pa këtë vlerësim të koston së jetesës, vlerësim i cili duhet t'i paraprijë përcaktimit të vlerës së pensioneve.

Sistemi i pensioneve në Kosovë është i rregulluar me ligje të cilat i ka miratuar Kuvendi. Në përputhje me të njëjtat, Qeveria duhet të veprojë vazhdimisht, në mënyrë që sistemi pensional të garantojë të drejtat e pensionistëve. Rritja e pensioneve duhet të jetë pjesë e një sistemi adekuat pensional ku pas vlerësimeve obligative, rritja vie si rezultat i natyrshëm. Kështu, në asnjë rrethanë, rritja e pensioneve nuk duhet të vlerësohet si mëshirë e Qeverisë ndaj pensionistëve, duke u ndërmarrë jashtë procedurave ligjore, në një kohë kur haptazi shfaqen dyshime për tendenca elektorale në këtë vendim.

Duhet përmendur faktin se rritje dinjitoze dhe të shpejtë të të ardhurave, gjatë qeverisjes në legjislaturën e VIII-të, mund të vërehet vetëm tek pozitat e larta publike. Para se të hynte në fuqi Ligji për Pagat në Sektorin Publik, paga e Kryeministrit ishte 1302 bruto euro, me hyrjen në fuqi të këtij ligji atij paga i'u rritë për 483 euro më shumë, pra në 1785 bruto euro në total. Paga e Ministrit, para LPSP ishte 1300 euro, me ndryshimet ligjore ajo u rritë për 422 euro më shumë, në total prej 1722 euro bruto në total. Deputetit, nga 1547 euro pagë bruto, atyre ju rritë për 175 euro më shumë. Në ndërkohë, në raport me rritjen e pagës në 2023, rritje për vitin 2024 u bë për 85 euro për Kryeministrin, 82 euro për ministrat dhe 38 euro për deputetët.

Rritja e shumës mujore e pensioneve, e bërë në muajin tetor, në secilën rrethanë është shumë më pak se kujdesi i Qeverisë dhe Kuvendit për t'i caktuar pagat dhe beneficionet për pozitat që anëtarët e këtyre dy institucioneve ushtrojnë. Vendimi i fundit, prek më së paku 148 mijë pensionistë të cilët i merrnin 100 euro, tani do t'i marrin 120 euro, por një ngritje e tillë e shumës së pensioneve, këta pensionistë nuk do t'i mbrojnë nga kufiri i varfërisë.

### **13. Intervenimi në skemat pensionale nga Qeveria dhe Kuvendi pas detyrimit nga Gjykata Kushtetuese**

Edhe pse siç u elaborua në kapitullin paraprak, reforma pensionale ishte një nga premtimet kyçe të fushatës elektorale të vitit 2021, Qeveria Kurti 2 nuk ndërmorri hapa konkret për përmbushjen e këtij premtimi, duke e lënë çështjen pezull për më shumë se katër vite. Kjo neglizhencë ka pasoja të rënda për mijëra qytetarë të Kosovës që mbeten të privuar nga e drejta e tyre për t'iu rritur pensionet sipas kostos së jetesës dhe inflacionit.

Përveç mosmbajtjes së premtimit për reformë në skemat pensionale, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi nuk morën për bazë raportin ex officio të Avokatit të Popullit mbi nevojën e rregullimit pozitiv të pensionit kontributpagues për kategorinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve, për shkak të largimit të dhunshëm dhe diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë.[43]

Gjykata Kushtetuese e Kosovës shfuqizoi një dispozitë të Ligjit për Skemat Pensionale, konkretisht paragrafin 2 të nenit 8, e cila në mënyrë diskriminuese u ndalonte mijëra qytetarëve të cilët nuk plotësonin kriterin e përvojës 15-vjeçare para janarit të vitit 1999 të përfitonin pensionin kontributdhënës. Këta individë ishin të detyruar të pranonin vetëm pensionin e moshës. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese erdhi pas një kërkesë të Gjykatës Supreme, e cila kishte ngritur shqetësime për kushtetutshmërinë e kësaj dispozite.

Pas këtij aktgjykimi, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës e pranuan me shkrim detyrimin për të ndryshuar Ligjin për Skemat Pensionale deri më 15 korrik 2023, dhe të njoftonin Gjykatën për nisjen e këtyre ndryshimeve. Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se kur një dispozitë shpallet e papajtueshme me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, ligjvënësit duhet të veprojnë për ta korigjuar atë gabim brenda afatit të caktuar, që në rastin e tanishëm afati për t'i bërë korigjimet e duhura ishte gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e aktgjykimit.

Megjithatë, kur më 25 janar 2023 Qeveria miratoi Programin Legjislativ për vitin 2023, në të nuk u përfshi miratimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale, duke injoruar kështu detyrimet e saj. Vetëm në maj, pas pesë ndryshimeve në programin legjislativ, Qeveria e përfshiu projektligjin në agjendë dhe caktoi miratimin e tij për 30 korrik 2023 – me 15 ditë vonesë nga afati i Gjykatës Kushtetuese.

---

[43] *Raporti Nr. 235/2018 Ex officio*, Avokati i Popullit të Kosovës; (Shih linkun: <https://humanrights.oik-rks.org/uploads/1575382654-RaportiEx%20officio%20235-2018.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).

Më 5 korrik 2023, Qeveria miratoi projektligjin, ku kryeministri Albin Kurti deklaroi se ky projektligj do të adresojë pabarazitë e mosnjohjes së të drejtave pensionale të mijëra qytetarëve të Kosovës. Por, projektligji nuk i'u nënshtrua konsultimeve publike, nuk pati dialog social me përfaqësuesit e pensionistëve dhe nuk u përfshinë shoqëria civile në dhënien e komenteve që një ligj i tillë të mos përmbajë më të meta kushtetuese. Në ndërkohë, projektligji u miratua me procedurë të përshpejtuar, por që përkundër shmangies nga procedurat e rregulla një ligj i tillë nisi së zbatuar tek në janar të vitit 2024, ku mijëra pensionistëve në mënyrë retroaktive u dolën pensionet për gjashtë muajt e vitit 2023.

Kësisoj, ndryshimi i tillë ku që nga viti 2000, u diskriminuan me mijëra qytetarë të Kosovës, ndodhi vetëm pas detyrimit që GjK e bëri nëpërmjet Aktgjykimit të saj në rastin KO190/19.[44]

---

[44] *Aktgjykim në rastin KO190/19*, Parashtrues Gjykata Supreme e Kosovës; Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/01/ko\\_190\\_19\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/01/ko_190_19_agj_shq.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 3 gusht 2024).





